

## ARSIMI I DETYRUAR NE ITALI

Nga 15 nëntori 2023 ligji që rregullon frekuentimin e shkollës nga 6 deri në 16 vjeç ka ndryshuar

### DEKRET – LIGJI 15.09.2023, N.123

Neni 12 parashikon forcimin e respektimit të arsimit të detyrueshëm.  
Ndryshon nenin 114 të dekretit legjislativ të 16 prillit 1994, nr. 297 (mbikëqyrje mbi përmbushjen e detyrimit arsimor) të tekstit të konsoliduar të dispozitave legjislative në fuqi për arsimin.

Për të garantuar përmbushjen e detyrimit arsimor, kryetari i bashkisë identifikon të miturit që nuk respektojnë detyrimin e përmendur me sipër dhe paralajmëron pa vonesë personin përgjegjës për përmbushjen e detyrimit, duke e ftuar të zbatojë ligjin.

Ky nen ligj përcakton përgjegjësinë e prinderve për sigurimin e arsimit të detyrueshëm për fëmijë e moshës 6 deri në 16 vjeç që banojnë në Itali.

- 1) Prindërit duhet të rregjistrojnë fëmijët në shkollë.
- 2) Prindërit duhet të dërgojnë fëmijët në shkollë.

Kryetari i bashkisë ka detyrimin të verifikojë nëse prindërit e respektojnë këtë ligj

Skolla është e detyruar të komunikojë prindërit se një nxënës i cili mungon për 15 ditë brenda tre muajve pa arsye të justifikuar duhet të kthehet në shkollë.

Nëse pas këtij komunikimi familja nuk i arsyeton në mënyrë të përshtatshme mungesat ose nuk e kthen fëmijën në shkollë, drejtori i shkollës ka detyrimin t'i raportojë kryetarit të bashkisë për mos pjesëmarrjen.

Shkolla merr përgjegjësinë për të vendosur kriteret e "arsyes së justifikuar". Arsyet e njohura mund të jenë sëmundje (nëse ekziston një certifikate mjeksore), ose probleme të tjera serioze që duhen justifikuar.

Një delegat i kryetarit të bashkisë i dërgon një letër paralajmëruese familjes duke i ftuar prindërit që të kthejnë sërish në shkollë fëmijët brenda një jave.

Paralajmërimi thotë që ta dërgoni fëmijën në shkollë brenda një jave nga marrja e letrës dhe të kontaktoni menjëherë zyrën.

Nëse i mituri kthehet në shkollë, procesi përfundon.

Në rast të moskthimit të të miturit në shkollë, pa arsye të justifikuar, nëse i mituri tashmë i shmanget shkollimit të detyruar, kryetari i bashkisë ka detyrimin të vijojë me kallëzimin në Prokurori.

Zyra përgjegjëse për Bashkinë e Venezia është Inadempienza scolastica ( mosplotësimi Shkollor) e Servizio di Progettazione Educativa ( Sherbimi i Planifikimit Arsimor).

Në letrën paralajmëruese, ftohen prindërit që të kthejnë sërish në shkollë fëmijën brenda një jave nga marrja e saj dhe ti telefonojnë zyrës.

Kur telefononi fiksohet një takim, prindërit duhet të paraqiten dhe të dërzojnë dokumentat që justifikojnë arsyet e mungesave të fëmijës në shkollë, për shëmbull certificata e mjekut.

Zyra verifikon me shkollën kthimin aktual të fëmijës.

Nëse i mituri nuk kthehet në shkollë dhe tashme ka bere shume mungesa ( shmangie), prindërit duhet të justifikojnë arsyet e mungesave.

Arsyet e njohura mund të jenë sëmundja (nëse ekziston ndonjë certifikatë mjeksore) ose probleme të tjera serioze të cilat duhet të justifikohen me paraqitjen e dokumentacionit të certifikuar dhe të vlefshëm që do të vlersohet nga drejtori i sektorit.

Nëse arsyet e mungesave nuk konsiderohen të vlefshme, Zyra raporton në Prokurori.

Ligji ka përcaktuar se mosregjistrimi dhe mungesa e pajustificuar e fëmijëve në shkollë është krim i parashikuar nga kodi i procedurës penale:

Neni 570-ter i Kodit të Procedurës Penale/

Mosplotësimi i Detyrimit për arsimimin e të miturit thotë:

Personi përgjegjës për përmbushjen e detyrimit arsimor, i cili, pasi është paralajmëruar, nuk përpiqet të sigurojë arsimimin e të miturit në ndonjë mënyrë tjetër ose nuk justifikon, për arsye shëndetësore ose pengesa të tjera të rënda, mosregjistrimin e të miturit në një shkollë në sistemin arsimor kombëtar ose nuk jua paraqet brenda një jave nga paralajmërimi "dënohet me burgim gjer në dy vjet." Për mungesa të pajustificuara të të miturit që përbëjnë shmangie drejt detyrimit arsimor, të pajustificuara për arsye shëndetësore ose pengesa të tjera të rënda, dënohet me burgim gjer në një vit.

Prokurori publik e njofton pa vonesë prokurorin e republikës pranë gjykatës për të mitur.

Senjalizimi i mosregjistrimit në gjykatë sjell dënimin e mundshëm dhe si pasojë dënimin me burg deri në dy vjet.

Senjalizimi për mos frekuentim të shkollës (shmangie\*) çon në një dënim të mundshëm deri në një vit burg.

Ky dënim mund të çojë në një sërë pasojash për prindërit në lidhje me aspekte të ndryshme të jetës në Itali (për shëmbull bllokimi i ndihmës së përfshirjes për familjen).

\* Shmangie e detyrimit shkollor : kur minoreni bën shumë mungesa dhe grumbullojnë një numër orësh mungesash që kalojnë një të katërtën e numrit total të ditëve të parashikuara gjatë gjithë vitit shkollor